
Termet e Referencës

Pozita: Konsulent për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)
Kohëzgjatja: [40-60] ditë pune gjatë periudhës [shëno periudhën]

Sfondi

Komuna e [shëno komunën] është duke e hartuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartën Zonale të Komunës (HZK). Të dy dokumentet PZHK dhe HZK duhet të shihen si një proces koherent dhe i integruar i planifikimit hapësinor me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm afat-gjatë komunal.

Siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimet Administrative të ndërlidhura, të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor duhet të jenë në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM). Ligji i Kosovës për VSM thekson se "hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik (...) të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve". Këto Terma të Referencës janë të përcaktuara për një VSM që duhet të kryhet në përputhje me Direktivën e BE-së 2001/42/EC mbi Vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis dhe me Ligjin e Kosovës Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Qëllimi i detyrës

Objektivi i përgjithshëm i konsulencës është që të rrisë qëndrueshmërinë e procesit të planifikimit hapësinor komunal. Objektivi i veçantë është që të kryhet VSM-ja e Planit Zhvillimor Komunal dhe e Hartës Zonale për komunën e [shëno komunën]. VSM-ja do të përshkruajë, identifikojë dhe vlerësojë efektet e rëndësishme të mundshme që të dy PZHK-ja dhe HZK-ja do t'i kenë në mjedis. Duke vepruar kështu, VSM-ja do të ofrojë rekomandime në nivel strategjik se si efektet negative potenciale që rrjedhin nga zbatimi i PZHK-së dhe HZK-së mund të minimizohen dhe si mund të rriten efektet pozitive. Të gjeturat dhe rekomandimet do të merren parasysh gjatë procesit të hartimit të dy dokumenteve të planifikimit komunal, për zbatimin dhe shqyrtimin e PZHK-së dhe HZK-së.

VSM-ja do t'ju ofrojë vendim-marrësve në nivel lokal dhe qendror në Kosovë, informacionet e duhura për t'i vlerësuar sfidat dhe çështjet mjedisore lidhur me strategjitë komunale të zhvillimit hapësinor, kornizën e zhvillimit hapësinor, si dhe hartimin e masave konkrete të zonimit. VSM-ja duhet të sigurojë që shqetësimet mjedisore të integrohen në mënyrë të duhur në strategjinë e planifikimit hapësinor komunal, masat e zbatimit dhe proceset e monitorimit. Është paraparë se VSM-ja po ashtu do të ndikojë në projektet strategjike investuese në nivel lokal.

Konsulenti, gjatë kryerjes së detyrave të VSM-së, do t'i referohet dhe konsultohet me legjislacionin dhe Udhëzimet administrative përkatëse në lidhje me zhvillimin dhe hartimin e planeve hapësinore dhe vlerësimin strategjik mjedisor (Aneksi 1), dhe veprëjë me respekt për një proces transparent, të planifikimit me pjesëmarrje dhe me një qasje të ndjeshme gjinore.

Ndarja e punës

Konsulenti do të përqendrohet në dy detyra kryesore, të përshkruara më poshtë, të cilat duhet të kryhen gjatë periudhës prej [shëno periudhën] dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komunën e [shëno komunën] dhe ekupeve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Fushëveprimi kryesor i punës është i ndërlidhur me VSM-në për të dy dokumentet e planifikimit hapësinor komunal (PZHK dhe HZK) dhe duhet të përfshijë një bashkëpunim të ngushtë me një varg të larmishëm të palëve të interesuara, dhe me përfshirjen e anketave dhe analizës.

Konsulenti për VSM do të jetë përgjegjës për dy detyrat kryesore të mëposhtme:

Detyra 1: Të kryej VSM-në për PZHK-në e [shëno komunën].

Detyra 2: Të kryej VSM-në për HZK-në e [shëno komunën].

Detyra 1 do të jetë e strukturuar në dy pjesë kryesore: një studim bazik/fushëveprimi dhe raporti i VSM-së për PZHK. Studimi i fushëveprimit do të identifikojë çështjet mjedisore që do të jenë fokusi i studimit të VSM-së, duke marrë parasysh kontekstin specifik mjedisor në komunë. Detyra 2 do ta merr për bazë studimin bazik dhe analizën mjedisore të hartuar gjatë Detyrës 1 dhe do të strukturohet në një raport të VSM-së për HZK-në.

Detyrat kryesore

Konsulenti për VSM do të jetë përgjegjës për detyrat kryesore vijuese, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e MMPH-së dhe homologëve komunal:

Detyra 1: VSM për PZHK

1. Gjetjen e fakteve/mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë vizitat e strukturuar të terrenit në komunë.

2. Të kryej shqyrtimin paraprak të çdo materiali ose dokumenti të prodhuar në lidhje me hartimin e PZHK-së dhe HZK-së në lidhje me ndikimet e tij sociale, ekonomike dhe mjedisore - kjo, ndër të tjera, përfshin PZHK-në, HZK-në, Planet Rregulluese të Hollësishme (PRrH), udhëzimet komunale, projekt dokumentet e atyre iniciativave me të cilat pritet bashkëpunimi i ngushtë, raportet e monitorimit në nivel komunal; Të kryej një shqyrtim të detajuar të çdo kapitulli të PZHK-së, t'i analizojë ato kundrejt ndikimeve të mundshme mjedisore dhe të jap komente me shkrim për diskutim të mëtejshëm me ekipin kryesor të PZHK-së;

3. Të kryej shqyrtimin sekondar - qëllimi i shqyrtimit sekondar do të jetë të shqyrtojë se si përkushtimi komunal për mbrojtjen e mjedisit është priorizuar në kuadër të procesit të planifikimit dhe ndarjes së buxhetit;

4. Të kryej një analizë të mangësive të palëve të interesit, si plotësim i analizës së palëve të interesit të kryer për procesin e planifikimit hapësinor komunal. T'i identifikojë palët kryesore mjedisore të interesit (grupet kyçe dhe institucionet, agjencitë mjedisore, OJQ-të, përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat), duke përfshirë grupet të cilat potencialisht mund të preken nga ndikimet e mundshme mjedisore të zbatimit të PZHK-së dhe HZK-së dhe se mund të mos janë marrë në konsideratë gjatë fazës së hartimit të PZHK-së/HZK-së. Theks i veçantë duhet t'i jepet grupeve minoritare, rinisë, fëmijëve, dhe grupeve të rrezikuara sociale, duke pasur parasysh një analizë të ndjeshme-gjinore. Bazuar në këtë analizë duhet të propozohet një listë e palëve të interesit e balancuar në aspektin gjinor, së bashku me shqetësimet e palëve kyçe të interesit dhe vlerave në lidhje me PZHK-në dhe HZK-në në fjalë, dhe një strategji e propozuar për angazhimin e palëve kyçe të interesit për të rënë dakord me ekipin komunal të planifikimit në mënyrë që të jenë të koordinuar me planin e përgjithshëm të konsultimit të planifikimit hapësinor dhe për t'i shmangur konfliktet e panevojshme, rritjen e pritjeve të paarsyeshme ose për të krijuar "lodhje nga pjesëmarrja";

5. Studimi i fushëveprimit të VSM-së që përshkruan fushëveprimin e bazës mjedisore të nevojshme për studimin e VSM-së dhe fokusohet në temat e mëposhtme:

- Një përshkrim i gjendjes aktuale të mjedisit në komunë; analiza e trendëve të aspekteve të ndryshme mjedisore; përshkrimi i informacionit në dispozicion dhe identifikimi i mangësive të të dhënave; elementet kyçe të kontekstit socio-ekonomik;

- Identifikimi i palëve kyçe të interesit dhe shqetësimet e tyre (lidhur me qëndrueshmërinë mjedisore të komunës dhe implikimet e mundshme të zbatimit të PZHK/HZK); përshkrimi i mekanizmave të angazhimit të palëve të interesit të propozuar për studimin e VSM-së;

- Përshkrimi i legjislacionit, planeve, programeve, Direktivave përkatëse të BE-së; prezantim i shkurtër i politikave dhe objektivave përkatëse mjedisore në nivel lokal dhe qendror;

- Përshkrimi i shkurtër i draft planit për të lehtësuar të kuptuarit e analizës së VSM-së;

- Evoluimi i mundshëm i kontekstit pa planin; identifikimi paraprak i ndikimeve kyçe të PZHK-së dhe HZK-së në mjedis;

- Shqyrtimi i problemeve kryesore të mjedisit dhe mundësive;

- Vlerësimi i Konceptit të Zhvillimit Hapësinor të PZHK-së¹;
- Identifikimi i çështjeve kyçe mjedisore të cilat ndikojnë në përzgjedhjen e prioriteteve mjedisore dhe sociale.

Ky identifikim i propozuar i çështjeve kyçe duhet të bazohet në punën analitike, duke përdorur analizën hapësinore, rastet e studimit dhe metodat e vlerësimit me pjesëmarrje; ndërtimi i një harte bazë duke përdorur informacion mbi mbulueshmërinë me pyje, basenet e lumenjve dhe trupave të ujit, dhe karakteristikat e spikatura të biodiversitetit, duke përfshirë pikat e koncentruar të biodiversitetit dhe të zonave të mbrojtura; mbivendosjen me hartën e infrastrukturës ekzistuese dhe të propozuar, projekteve kryesore të prodhimit ekzistuese apo të propozuara dhe identifikimin e zonave kritike nën apo me potencial të stresit të mundshëm mjedisor;

- Identifikimi i objektivave, treguesve dhe caqeve të VSM-së.

6. Raporti i VSM-së me fokus në temat e mëposhtme:

- Vlerësimi mjedisor i PZHK-së, duke marrë parasysh ndikimet e mundshme mjedisore të zbatimit të PZHK-së, shkalla në të cilën dokumenti adreson shqetësimet kryesore mjedisore të sektorit, dhe konsistencën e tij ndaj politikave dhe objektivave mjedisore të nivelit qendror dhe lokal;

- Rekomandimet strategjike për zbatimin dhe shqyrtimin e PZHK-së, duke pasur parasysh rritjen e performancës së saj mjedisore dhe integritimit mjedisor në strategjitë dhe veprimet lokale të planifikimit hapësinor. Rekomandimet do të përfshijnë treguesit e performancës, si dhe masat e mundshme përcjellëse për t'i trajtuar dobësitë e identifikuar, veçanërisht në fushën e ujit dhe menaxhimit të mbeturinave; rekomandimet duhet të bëhen mbi nevojën për të kryer Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) të çdo projekti që rezulton nga zbatimi i PZHK-së. Rekomandimet duhet të marrin parasysh mendimet e paraqitura nga palët e interesit dhe të shpjegojnë se si janë integruar këto në VSM. Në rast se shqetësimet nuk janë integruar në rekomandimet përfundimtare, ofroni shpjegimin për arsyet;

7. Angazhimi i palëve të interesit. Konsulenti do të sigurojë që palët kyçe të interesit të identifikuar të jenë plotësisht të angazhuar në detyrat e VSM-së, siç është planifikuar gjatë procesit të shqyrtimit dhe raportit të fushëveprimit. Angazhimi i palëve të interesit duhet të përfshijë një përzjerje të teknikave të ndryshme, të tilla si pyetësorë, intervista të fokusuar gjysmë të strukturuar (semi-structured interviews), dhe punëtorive me palët kryesore të interesit duke u fokusuar në identifikimin e objektivave, caqeve dhe treguesve për studimin e VSM-së, dhe ngritjen e vetëdijes mjedisore gjatë procesit. Kjo do të përfshijë një punëtori për të prezantuar rezultatet e fazës së shqyrtimit/fushëveprimit; dhe një prezantim të metodologjisë së VSM-së, dhe gjetjeve, ekipeve të MMPH-së/komunale dhe të gjithë palëve përkatëse të interesit.

Detyra 2: VSM për HZK

8. Analizën e të dhënave dhe përgatitjen me shkrim të raportit, të nxjerrur nga raporti i mëparshëm i fushëveprimit dhe VSM-së të kryer gjatë detyrës 1;

9. Pyetjet kyçe për t'u adresuar në raportin e VSM-së për HZK:

- a. Vlerësimi i skenarëve: Përfitimet kryesore dhe problemet/rreziqet;
- b. Rekomandimet për përfshirjen mjedisore (p.sh. infrastruktura e gjelbër, shërbimet e ekosistemit, përmirësimi i filtrimit të shtratit të lumit/restaurimin urban të rrjedhës);
- c. Analiza shumë-kriterëshe, analiza kosto-përfitim;

10. Angazhimi i palëve të interesit. Të zhvillohet një punëtori me stafin komunal dhe akterët lokal mjedisorë për të mbështetur hartimin e HZK-së mbi integrimin e mundësive të përfshirjes mjedisore në kornizën e re të Zhvillimit Hapësinor dhe të vlerësojë performancën mjedisore të HZK-së së propozuar; Prezantimi i raportit përfundimtar të VSM-së për HZK-në dhe debati publik.

Fillimi i konsulencës është planifikuar për [shëno datën] dhe pritet të përfundojë deri më [shëno datën]. Përveç hartimit/përgatitjes së studimit mbi fushëveprimin e VSM-së dhe raporteve të VSM-së, konsulenti do të kontribuojë në rritjen e vetëdijesimit mbi mjedisin në nivelin komunal nëpërmjet prezantimeve për VSM-në dhe debateve publike me palët e interesit në nivel lokal.

¹ Siç është paraparë me draft *Udhëzimin Administrativ mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal*

Rezultatet përfundimtare:

Gjatë detyrës, konsulenti do të dorëzojë dokumentet vijuese:

- Komentet me shkrim për të gjithë kapitujt e njëpasnjëshëm të dokumenteve të PZHK-së /HZK-së;
- Bazuar në procesin e shqyrtimit, vlerësimeve në terren dhe procesin e konsultimit me palët e interesit, studimi i fushëveprimit të VSM-së i përgatitur me mangësitë e identifikuar në lidhje me atë që është e nevojshme për përfshirjen mjedisore sipas objektivave të PZHK-së dhe "ku jemi ne" (struktura ekzistuese e institucioneve dhe politikave për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore) në përmbushjen e tyre. Të gjeturat e analizës bazë do t'i shërbejnë VSM-së së PZHK-së si dhe të HZK-së dhe duhet të përfshijnë një raport bazë të analizës gjinore me fokus në identifikimin e mangësive gjinore në qasjen ndaj rreziqeve ekonomike, klimatike dhe menaxhimit të burimeve natyrore; vendimmarrjes me rekomandimet e dhëna për t'i adresuar mangësitë gjinore në formulimin e treguesve gjinorë të rëndësishëm për përfshirjen mjedisore lokale në planifikimin e zhvillimit afatgjatë në nivelin komunal nëpërmjet testimit të objektivave mjedisore kundrejt alternativave të PZHK-së/HZK-së, masave zbutëse etj.
- Prezantimet e gjetjeve, komenteve dhe rekomandimeve për të ecur përpara, gjatë takimeve me të gjithë homologët;
- Draft versionet e të dy Raporteve të VSM-së duhet të dorëzohen për shqyrtim publik së bashku me draftet e PZHK-së/HZK-së.
- Versionet përfundimtare e të dy raporteve të VSM-së

Koha e saktë e dërgesave do të përcaktohet gjatë kryerjes së detyrave.

Kualifikimet

Arsimimi

Diplomë Universitare në Planifikimin hapësinor dhe urban, Studime Mjedisore apo diplomë ekuivalente relevante akademike.

Përvoja e punës dhe kërkesat e tjera

- Minimum pesë vjet përvojë profesionale praktike në fushën përkatëse;
- Njohuri të shkëlqyeshme të Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe praktikë në fushat e ngjashme të tilla si monitorimi dhe vlerësimi dhe planifikimi strategjik, planet zhvillimore komunale, veçanërisht në lidhje me kërkesat e BE-së në këtë fushë;
- Njohja me praktikat e planifikimit hapësinor;
- Përvojë në zhvillimin e skenarëve dhe analizave, duke përfshirë aspektet për barazi gjinore;
- Përvojë në zhvillimin dhe organizimin e punëtorive dhe prezantimeve publike për përfshirjen e palëve të interesit;
- Njohuri të mira të proceseve të zhvillimit lokal, ekonomisë së gjelbër dhe koncepteve të kontabilitetit eficient, mbrojtjen e mjedisit dhe të koncepteve të infrastrukturës së gjelbër;
- Aftësi për të punuar në ekip dhe për të ndërmarë iniciativë për sigurimin e marrëdhënieve të qeta dhe komunikimit të hapur brenda ekipit dhe me partnerët;
- Aftësi të mira analitike, përcaktimit të zgjidhjes dhe shkathhtësi kreative;
- Aftësi të mira të prezantimit dhe shkruarjes së raporteve;
- Përvoja e mëparshme nga rajoni i Evropës Jug-Lindore;
- Është e domosdoshme që kandidati të jetë në gjendje t'i përmbushë afatet kohore për raportimin dhe të gjithë punën e projektit.

Shtojca 1 - Lista e Legjislacionit të Kosovës mbi mjedisin dhe dokumentet tjera përkatëse që duhet të merren parasysh

Legjislacioni i Kosovës për mjedisin dhe planifikim hapësinor që duhet të merret parasysh:²

Nr. i Ligjit	Ligji për	Nr. Gazetës Zyrtare
03/L-025	Mbrojtjen e Mjedisit	50/06.04.2009
04/L-174	Planifikimin Hapësinor	30/23.08.2013
03/L-230	Vlerësimin Strategjik Mjedisor	83/29.10.2010
03/L-214	Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	83/29.10.2010
03/L-233	Mbrojtjen e Natyrës	85/09.11.2010
04/L-086	Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	02/21.01.2013
04/L-087	Parkun Kombëtar "Sharri"	02/21.01.2013
02/L-078	Shëndeti Publik	35/15.08.2008
03/L-043	Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes	52/08.05.2009
03/L-160	Mbrojtjen e ajrit nga ndotja	67/29.03.2010
02/L-102	Mbrojtjen nga zhurma	40/15.10.2010
04/L-197	Kimikate	18/26.03.2014
04/L-060	Mbeturina	17/29.06.2012
03/L-119	Produktet Biocide	55/10.07.2009
04/L-147	Ujërat e Kosovës	10/29.04.2013
02/L-79	Veprimtaritë hidrometeorologjike	25/01.06.2008
04/L-120	Mbrojtjen e bimëve	1/17.01.2013
02/L-98	Mbrojtjen e varieteteve të bimëve	40/15.10.2008
04/L-013	Kadastër	13/01.09.2011
04/L-110	Ndërtim	18/03.07.2012
02/L-26	Tokat bujqësore	13/01.06.2007
04/L-040	Rregullimin e tokës	3/22.02.2012
03/L-163	Minierat dhe mineralet	80/27.08.2010
04/L-158	Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-163 për minierat dhe mineralet	11/02.05.2013
03/L-104	Mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare	66/17.03.2010
04/L-067	Për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore	18/03.07.2012

²Disa ligje mund të përmbajnë legjislacione sekondare shtesë, si udhëzime administrative.

Veprimet strategjike, raportet, dhe studimet kryesore ekzistuese për mjedis dhe planifikimit Strategjik. Vlerësimi Strategjik Mjedisor pritet të merr në konsideratë dhe të shqyrtojë dokumentet e mëposhtme:

Veprimet Strategjike	Autoritet
Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020 +	MMPH
Plani Hapësinor Komunal (nëse është e përshtatshme)	Komuna
Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020	MMPH
Strategjia për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm	MMPH
Plani i Kosovës për veprim në mjedis	MMPH
Plani lokal i veprimit në mjedis	Komuna
Plani i Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave	MMPH
Strategjia e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave	MMPH
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit	MMPH
Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë	MBPZhR
Strategjia e Energjisë	MZhE
Strategjitë e tjera sektoriale po ashtu mund të konsultohen	Qeveria

Shtojca 2 - Formati standard për raportet mjedisore

Kapitulli	Përmbajtja	Informacionet që duhet të ofrohen në raportet e VSM-së ³
Kapitulli 0	<i>Përmbledhje e procesit të VSM-së dhe e efekteve të mundshme domethënëse të planit për mjedisin</i>	<i>Një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë në raport</i>
Kapitulli 1. Hyrja	<i>Qëllimi i VSM-së; përshkrimi i proceseve të planifikimit/ VSM; përshkrimi i strukturës së raportit</i>	<i>[Nuk përmendet në legjislacion]</i>
Kapitulli 2. Korniza strategjike dhe Përmbledhja e draft-planit	<i>Përshkrimi i legjislacionit, planeve, programeve relevante dhe direktivave relevante të BE-së</i> <i>Përshkrim i shkurtër i draft-planit për lehtësimin e kuptimit të analizave të VSM-së</i>	<i>Një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe lidhja me planet ose programet e tjera</i>
Kapitulli 3. Baza mjedisore	<i>Kushtet aktuale dhe tendencat e aspekteve të ndryshme mjedisore; përshkrimi i informatave në dispozicion dhe identifikimi i zbrazësive të dijes; elemente kyçe të kontekstit socio-ekonomik; zhvillimi i mundshëm i kontekstit pa plan</i>	<i>Aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimi i mundshëm i saj, pa zbatimin e planit</i> <i>Karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm</i>
Kapitulli 4 Çështjet kyçe mjedisore dhe objektivat e VSM-së	<i>Shqyrtimi (studimi) i problemeve dhe mundësive kryesore mjedisore; identifikimi i objektivave/indikatoreve dhe synimeve të VSM-së</i>	<i>Çfarëdo problemi ekzistues mjedisor që është relevant me planin, përfshirë, në veçanti ato që lidhen me çfarëdo zone të një rëndësie të veçantë mjedisore</i> <i>Objektivat e mbrojtjes mjedisore (të krijuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar ose të Komunitetit Evropian), të cilat janë relevante për planin dhe mënyrën se si këto objektiva ose çështje mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit</i>
Kapitulli 5. Analiza e pajtueshmërisë e objektivave të planit	<i>Analiza e pajtueshmërisë ndërmjet objektivave të planit dhe objektivave të VSM-së, si dhe elementet përkatëse të kornizës strategjike (p.sh. planet dhe programet e tjera përkatëse). Mund të përfshijë përshkrimin se si objektivat e planit janë zhvilluar gjatë procesit, për të reflektuar sugjerimet e VSM-së</i>	<i>Një përvijim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përvijim të mënyrës sesi u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë - të tilla si mangësitë teknike ose mungesa e njohurive teknike - të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar</i>
Kapitulli 6. Vlerësimi i efekteve mjedisore të planit	<i>Analiza të efekteve të planit, duke përfshirë krabasimin ndërmjet alternativave të arsyeshme (dhe arsytet për zgjedhjen) dhe propozimin e masave lehtësuese. Mund të bëhet ndarja në më shumë kapituj për të pasqyruar më mirë strukturën e planit. Përshkrimin se si janë përfshirë rezultatet e VSM-së në plan</i>	<i>Efektet më të rëndësishme të mundshme mbi mjedis në çështje të tilla si: biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimaterik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore, duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen e faktorëve të mësipërm</i> <i>Masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe sa më shumë të jetë e mundur të</i>

³ Për më shumë informata, referojuni Ligjit për VSM ose Udhëzuesit për VSM

Kapitulli	Përmbajtja	Informacionet që duhet të ofrohen në raportet e VSM-së ³
		<i>kompensojë ndikimet domethënëse negative në mjedis gjatë zbatimit të planit</i>
<i>Kapitulli 7. Plani i monitorimit</i>	<i>Indikatorët dhe qasja për monitorimin e zbatimit të planit</i>	<i>Një përshkrim i masave të parashikuara në lidhje me monitorimin</i>